

PROGRAMI KOMBËTAR I PRAKTIKAVE TË PUNËS

THIRRJA X

RISITË E THIRRJES DHJETË:

- ❖ **Kompensim financiar:** Praktikantët do të përfitojnë trajtim ushqimor në formën e kompensimit financiar, në vlerën 500 (pesëqind) lekë për çdo ditë praktike të kryer.
- ❖ **Zgjerimi i grupmoshës së përfituesve:** Aplikantët duhet të jenë të rinj nga mosha **21 deri në 29 vjeç**, të diplomuar në një **program studimi të ciklit të parë apo të ciklit të dytë**, të ofruar nga një institucion i arsimit të lartë.
- ❖ **Zhvillimi i trajnimeve profesionale:** Shkolla Shqiptare e Administratës Publike (ASPA), në bashkëpunim me Ministrinë e Shtetit për Rininë dhe Fëmijët, do të zhvillojë një program të posaçëm trajnimi, të hartuar mbi vlerësimin e njohurive e të kapaciteteve të nevojshme për angazhimin e profesionistëve të rinj pranë institucioneve të administratës shtetërore.

1. CILI ËSHTË QËLLIMI I PROGRAMIT?

Programi Kombëtar i Praktikave të Punës synon të përfshijë pjesëmarrësit në një eksperiencë pune të integruar e në ndërveprim me profesionistë karriere në administratën publike, me qëllim përfitimin e një përvojë kualifikuese që ndikon në zhvillimin e aftësive të tyre profesionale e të shprehive të tyre praktike, në njohje me sistemin administrativ publik.

2. KUSH MUND TË APLIKOJË?

Të rinjtë nga mosha **21 deri në 29 vjeç**, të diplomuar në ciklin e parë (*Bachelor*) apo ciklin e dytë (*Master*) të studimeve, të cilët nuk kanë qenë pjesë e programit në thirrjet e mëparshme.

3. SI REALIZOHET APLIKIMI?

Aplikimi realizohet **vetëm online**, përmes platformës zyrtare: praktika.riniafemijet.gov.al.

Dokumentet e nevojshme për aplikim:

- Jetëshkrimi (CV);
- Letra e motivimit.

Afati i aplikimit: 27 qershor – 10 gusht 2025 (45 ditë kalendarike).

4. SA ZGJAT PRAKTIKA DHE ÇFARË PËRFSHIN?

- Praktika zgjat tre muaj, nga **shtatori deri në dhjetor 2025**, me kohë angazhimi 6 orë në ditë, nga e hëna në të premte.
- Gjatë praktikës, praktikantët kryejnë detyra dhe angazhime të përcaktuara nga institucioni pritës, nën drejtimin e një **mbikëqyrësi**, i cili është përgjegjës për udhëzimin dhe vlerësimin e tyre përgjatë gjithë periudhës së praktikës.
- Përgjatë periudhës së praktikës, praktikantët ndjekin një **program të posaçëm trajnimi**, të zhvilluar nga Shkolla Shqiptare e Administratës Publike (ASPA), në bashkëpunim me Ministrinë e Shtetit për Rininë dhe Fëmijët. Program i posaçëm i trajnimit përfshihet në **vlerësimin përfundimtar të praktikantit** dhe finalizohet me lëshimin e një **certifikate** pas përfundimit me sukses të tij.

5. A KA PAGESË GJATË PRAKTIKËS?

Praktikantët **përfitojnë trajtim ushqimor në formën e kompensimit financiar**, në vlerën 500 (pesëqind) lekë për çdo ditë praktike të kryer, në bazë të listëprezencës së raportuar nga institucionet pritëse.

6. ÇFARË NDODH PAS PËRFUNDIMIT TË PRAKTIKËS?

- Pas përfundimit me sukses të PKPP, praktikantët **pajisen me certifikatë**, të lëshuar nga Ministri i Shtetit për Rininë dhe Fëmijët dhe Departamenti i Administratës Publike.
- Deri në **250 praktikantë** mund të përzgjidhen për punësim me **kontratë pune 1-vjeçare**, nga të cilët **deri në 200** në institucionet e administratës shtetërore dhe **deri në 50** në institucione të tjera publike. **Përzgjedhja bëhet nga institucionet pritëse**, bazuar në vlerësimin e performancës së praktikantëve gjatë praktikës.
- Periudha 3-mujore e praktikës dhe periudha 1-vjeçare e punësimit me kontratë **njihën si përvojë pune** gjatë procedurave të rekrutimit në institucionet e administratës publike.